

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“WIPRO GATEWAY”

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“WIPRO GATEWAY”

ORTAKU I VETËM

AIDEN IBRO

Tiranë, tetor 2024

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“WIPRO GATEWAY”

Sot më datë 07.10.2024 (dymijë e njëzet e katër) u paraqit personalisht:

Z. **Aiden Ibro**, i biri i **Ndriçimit**, i datëlindjes 11.12.2002, lindur në Tiranë e banues në Tiranë, Rruga Arkitekt Kasemi; Nd. 51/1; H. 1; Ap. 4; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia bashkiake nr. 2; 1001; Tiranë, identifikuar me ID me nr. personal **K212110490** madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Cel. + 0697301695,

i cili, në respektim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit civil shqiptar dhe konkretisht:

- Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,
- Ligjit nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", etj.,

me vullnet të lirë e të plotë, pasi paraprakisht ka kryer konsultimet ligjore në mënyrë të pavarur dhe nën përgjegjësinë e tij individuale, si dhe ka marrë të gjithë këshillën e nevojshme, në masën e gjykuar prej tij si të kënaqëshme, **paraqiti këtë Akt-Themelimi**, në Republikën e Shqipërisë, të shoqërisë me formën dhe përmbajtjen e mëposhtme:

NENI 1

EMËRTIMI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë është "WIPRO GATEWAY" sh.p.k. më poshtë e quajtur "Shoqëria".
- 1.2 Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar.

NENI 2

SELIA, LOGOJA DHE VULA E SHOQËRISË

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën provizore: Komuna Kërrabë, Fshati Mushqeta, Zona Kadastrale 2752, Nr. 110/3, Tiranë.
- 2.2 Shoqëria mund të vendosë për ndryshimin e selisë në gjithë territorin e vendit, si dhe ka të drejtë të krijojë hapjen e filialeve, degëve dhe zyrave të përfaqësimit në Shqipëri dhe jashtë saj.
- 2.3 Shoqëria do të ketë logon dhe vulën e saj.
- 2.4 Vula do të përdoret ekskluzivisht nga Administratori ose nga persona të autorizuar prej tij.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me afat të papërcaktuar.

NENI 4

OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
 - a. Ofrim të shërbimeve në funksion të ndërmjetësimit për rekrutimin e fuqisë punëtore në tregun shqiptar dhe të huaj, në funksion të përmbushjes së kërkesave të tregut të punës. Angazhim për rekrutim, ndërmjetësim dhe integrim të fuqisë punëtore vendase dhe të huaj, për nevojat e tregut të punës vendas, në përputhje me kërkesat ligjore dhe nevojat e punëdhënësve lokalë.
 - b. Ndërmjetësim për atraktimin e investitorëve në tregun shqiptar dhe jashtë vendit.
 - c. Ofrimin e konsulencës për investitorët në lidhje me aktivitete specifike.
 - Arsim: Ndërmjetësim në fushën e arsimit për të siguruar zgjedhjen më të mirë, në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë, për studentët shqiptarë dhe të huaj.

- Shitjen dhe blerje: Të produkteve ushqimore, tekstile, minerale, imobilare, farmaceutike, mjekësore, e të tjera
- d. Import dhe tregtim brenda e jashtë vendit të teknologjisë në funksion të objektit të aktivitetit. (paisje dhe software)
 - e. Blerje të shërbimeve në fushën ndërmjetësimit, brenda dhe jashtë vendit, me qëllim rishitjen apo mbulimin e nevojave të klientetëve.
 - f. Kryerjen e detyrave të ndërmjetësit, negociatorit e këshilluesit financiar. Verifikimi i transparencës në transaksione për individë, manaxherë të fondeve të pensioneve, bankat, kompanitë e sigurimit dhe institucione të tjera.
 - g. Përfaqësimi i kompanive apo shoqërive të ndryshme shqiptare dhe të huaja që kanë objekt të njëjtë apo të përafërt me atë të shoqërisë.
 - h. Kryerja e çdo veprimtarie tjetër që parashikon legjislacioni shqiptar në funksion të objektit të aktivitetit të shoqërisë.
- 4.2 Shoqëria mund të përfshihet në ngritjen, administrimin e pikave të ushtrimit të aktiviteteve të mësipërme dhe të tregëtimit të produkteve, zhvillimin e rrjeteve të brendëshme e të jashtme, shërbime administrative, shërbime marketingu e promovuese, etj.
- 4.3 Veprimtaritë e mësipërme kontribuojnë kryesisht në:
- A. zhvillimin e biznesit shqiptar në fushën objekt i aktivitetit të shoqërisë,
 - B. zhvillimin, lehtësim dhe përshtatshmërinë me tregun Evropian e botëror,
 - C. futjen e kapitaleve të huaja dhe ndërmjetësime për financime në Shqipëri
 - D. nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare dhe ato të vendeve të tjera të botës.
- 4.4 Për kryerjen e veprimtarisë së saj Shoqëria do të bashkëpunojë e lidhë marrëveshje me persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj.
- 4.5 Shoqëria mund të kryejë çdo operacion financiar, tregtar, shërbimi, industrial, me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, që mund të lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me një nga subjektet e sipërpërmendura.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR,

- 5.1 Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 10.000 (dhjetëmijë) Lekë i përbërë nga 1 (një) kuotë.
- 5.2 Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij si më poshtë:
Ortaku themelues:
Z. Aiden Ndriçim Ibro, i datëlindjes 11.12.2002, zotërues i kuotës me vlerë të përgjithshme që përbën 10.000 (dhjetëmijë) Lekë që përbën 100 (njëqind) % (përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 5.3 Kontributi është në Lekë.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakëve ndaj të tretëve, për detyrimet e Shoqërisë, kufizohet në masën e pjesëmarrjes së tyre në Kapitalin Themeltar.

NENI 6



ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 6.1 Shoqëria administrohet nga Administratori Z. Aiden Ibro, i biri i Ndriçimit, i datëlindjes 11.12.2002, lindur në Tiranë e banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal **K212110490**, madhor me zotësi juridike për të vepruar, i cili ka kompetencat e përfaqësimit të Shoqërisë dhe kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm, në përputhje me ligjin dhe statutin e Shoqërisë.
- 6.2 Administratori përfaqëson Shoqërinë ndaj të gjithë personave fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja. Administratori, në emër dhe për llogari të Shoqërisë, ka të drejtë të nënshkruajë çdo marrëveshje e kontratë, përfshirë kontratat e qirasë, kontratat për shitjen e pasurive të paluajtshme apo për vendosje të hipotekës mbi to, mund të nënshkruajë aktet përkatëse të themelimit të shoqërive të tjera në të cilat Shoqëria merr pjesë, si dhe aktet për ndryshimin e statutit të tyre, mund të përgatisë dhe zbatojë aktet në lidhje me përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt bankave shqiptare apo të huaja me qëllim çeljen, transferimin dhe mbylljen e llogarive bankare të Shoqërisë, të kryejë pagesa dhe tërheqje parash, të përfitojë financime, dhe në përgjithësi, të administrojë këto llogari në interes të Shoqërisë.
- 6.3 Administratori kryen të gjitha aktet që i konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç akteve që sipas ligjit apo statutit janë në kompetencë të Asamblesë së Ortakëve apo organeve të tjera të Shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin e Shoqërisë.
- 6.4 Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë.
- 6.5 Administratori ushtron kompetencat e mësipërme drejtpërdrejt ose nëpërmjet delegimit në favor të të tretëve. Administratori është në çdo rast përgjegjës për aktivitetin e të tretëve të cilëve ju janë deleguar këto kompetenca.

NENI 7

DISPOZITAT E ORGANIZIMIT

Dispozita më të hollësishme mbi organizimin, rregullat mbi drejtimin dhe administrimin e aktivitetit të shoqërisë dhe çështjet e brendshme, janë parashikuar në Statutin e shoqërisë, si dhe mund të specifikohen me akte të brendshme të funksionimit të veprimtarisë së shoqërisë, të cilat shprehin vullnetin e lirë të Themeluesve.

NENI 8

HYRJA NË FUQI

- 8.1 Ky Akt themelimi hyn në fuqi ditën që do të kryhet regjistrimi përkatës. Në këtë ditë Shoqëria njihet si person juridik.
- 8.2 I autorizuar për kryerjen e regjistrimeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave përkatëse ligjore për këtë qëllim është : Z. Aiden Ndriçim Ibro, me nr. personal **K212110490**.

NENI 9

GJUHA



Ky Akt themelimi është përpiluar në gjuhën shqipe.

NENI 10
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky Akt-Themelim është përpiluar në 4 (katër) kopje origjinale duke pasur fuqi të barabartë ligjore.

Pjesë përbërse të këtij Akti Themelimi është edhe kopja e Kartës së Identitetit të themeluesit.

ORTAKU I VETËM

AIDEN IBRO

(Aiden Ibro ✱)